



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 288 Prot.

Tiranë, më 13 /02/2017

VENDIM

Nr. 28, datë 13/2/2017

Në mbështetje të nenit 21, pika 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik",

VËREJ SE:

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (më tej, K.SH.H) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr.606 Prot., datë 27.12.2016, ndaj Organit Publik/Ministrit së Drejtësisë (më tej, organi publik), me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftim dhe konsultim publik për projektligjin "Për dhënie amnistie".

Rezulton se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 21, pika 1/b të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftim dhe konsultim publik", për shkak se projektakti është njoftuar i miratuar dhe si i tillë ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Gjithashtu, ankuesi legjitimohet edhe në ngritjen e kësaj ankese në përputhje me pikën 1/b të nenit 8 të ligjit 146/2014, në të cilën thuhet shprehimisht se "...palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit...". K.SH.H në zbatim të projektit "Për një Transparencë dhe pjesëmarrje më të lartë të grupeve të interesit në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse të organeve publike", konsiderohet grup interesi në lidhje me konsultimin publik.

Pas vlerësimit të ankesës së K.SH.H në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr.146/2014 në të cilin citohet se "...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 10 ditëve", Komisioneri me shkresën Nr. 1588/1 Prot., datë 04.01.2017 ka kërkuar nga organi publik të paraqesë parashtrime me shkrim brenda këtij afati.

Organi publik në parashtrimet e depozituara me shkresën Nr. 271/1 Prot., datë 18.01.2017, lidhur me mos ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik parashikuar në ligjin nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", parashtron se:

- Projektligji "Për dhënie amnistie", bazuar në ligjin nr. 9000/2003, ka kaluar një proces konsultimi paraprak vetëm pranë Ministrit së Punëve të Brendshme, Ministrit së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Gjykatës së Lartë, Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
- Projektligji "Për dhënie amnistie" është/ dhe e ka trajtuar të një natyre të veçantë, si një nismë në diskrecion të autoritetit kompetent shtetëror, për shkak se amnistia është

një masë e tillë nëpërmjet të cilës shteti “heq dorë” nga zbatimi i dënimit për disa krime të caktuara.

- *“...projektligji për dhënie amnistie nuk ka thelbësisht natyrën e një projektakti ku mund të reflektohen mendimet e aktorëve të interesuar. Nëse do të kishte një proces konsultimi të mirëfilltë, në kuptim të ligjit nr. 146/2014, të gjithë të dënuarit do të sugjeronin përfshirjen në projektligj të veprave penale për të cilat janë dënuar. Për më tepër amnistia si proces është delikat, për shkak se përjashton jo vetëm vuajtjen nga dënimi por edhe nga ndjekja penale e një kategorie të caktuar veprash penale që parashtrajnë një marzh dënimi deri në 2 vjet që si rregull mund të shtrihen deri një ditë para shpalljes së amnistisë ose një date tjetër të përcaktuar me ligj. Duke u bërë publike një datë konkrete amnistie nga ndjekja penale, ekziston rreziku që persona të ndryshëm të ndër marrin iniciativën për konsumimin e veprave penale, të cilat mund të përfshihen në amnisti...”*
- Projektligji prek një kategori të caktuar individësh, konkretisht interesat të personave të dënuar me vendim të formës së prerë dhe vepron brenda një date të caktuar dhe se të dënuarit janë fillimisht përfitues të zbatimit të këtij projektligji, jo palë e përfshirë në konsultim publik.
- Projektligji është publikuar në faqen zyrtare të organit publik, por fazën e konsultimit dhe reflektimit të mendimeve e ka kufizuar vetëm në institucionet publike të cilat zbatojnë apo ndjekin drejtpërdrejtë politikën dhe legjislacionin penal.

Në arsyetim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri konstaton se pretendimet bien ndesh me kërkesat e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Konsultimi publik është një proces që duhet zbatuar në kuadër të transparencës, njohjes, konsultimit dhe edukimit ligjor nga të interesuarit, kategori e përcaktuar në këtë ligj.

Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” vetëm për rastet e parashikuara në nenin 4 të tij, kufizon ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të një projektakti ligjor nënligjor apo të një dokumenti strategjik të rëndësishëm.

- Konkretisht në këtë dispozitë parashikohet:

“Dispozitat e këtij ligji nuk parashikohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me:

- a) çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;*
- b) marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe;*
- c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;*
- ç) aktet normative me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave;*
- d) emergjencën civile;*
- dh) çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj”.*

Pas konsultimit të secilit kufizim të parashikuar në këtë dispozitë dhe përkufizimeve të specifikuar në to (si “siguri kombëtare”, akte administrative individuale”, emërgjencë civile”, etj), por edhe referuar parashtrimeve të organit publik në të cilat nuk argumentohet mbi këtë dispozite, nuk rezulton që projektligji të nënshtrohet përkufizimeve të kësaj dispozite.

Në kushte të tilla, konstatohet se procesi i konsultimit të projektligjit nga organi publik është bërë në kundërshtim me çfarë parashikon ligji për njoftimin dhe konsultimin publik.

gjuna jazar, duke jjuuar nga publikimi i projektaikut, marrja e komentëve ane rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar”.

Pika 1 e nenit 8 të ligjit 146/2014, përkufizon qartë kuptimin e palëve të interesuara. Sipas kësaj dispozite ato janë, “*organet publike, shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit, ...*”. Në kundërshtim më këtë dispozitë, organi publik pretendon të trajtojë vetëm përfituesit e këtij projektligji si grup interesi, duke përfshuar kategoritë e tjera të këtij përkufizimi nga konsultimi i projektaktit.

Për të gjithë konstatimet e përmendura më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 4 të nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 606 Prot., datë 27.12.2016 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit kundër Autoritetit Publik/Ministrisë së Drejtësisë, me objekt “*Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftim dhe konsultim publik për projektligjin “Për dhënie amnistie”.*
2. Ti propozoj organit publik/Ministrisë së Drejtësisë, marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës (në kuptim të nenit 10 të këtij ligji), sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim u shpall sot në datë 13.02.2017

